



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

Nr. 1523 prot. datë 25.02.2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE
DHE EKONOMISË

Nr. 4276/1 prot. datë 9.3.2020

URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 71, datë 25.02.2020

PËR

MIRATIMIN E STRUKTURËS SË VITIT SHKOLLOR 2020 – 2021 NË SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 26, e të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenit 7 të ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJMË:

Struktura e vitit shkollor 2020 - 2021 të jetë si më poshtë:

1. Në arsimin bazë:
 - a) Mësimet fillojnë më 14 shtator 2020 dhe mbarojnë më 8 qershor 2021.
 - b) Pushimet fillojnë më 24 dhjetor 2020 dhe mbarojnë më 4 janar 2021.
 - c) Provimet kombëtare të arsimit bazë zhvillohen në periudhën 9 - 30 qershor 2021.

2. Në arsimin e mesëm të lartë
 - a) Mësimet fillojnë më 14 shtator 2020 dhe mbarojnë më 15 qershor 2021.
 - b) Për maturat, mësimet fillojnë më 14 shtator 2020 dhe mbarojnë më 1 qershor 2021.
 - c) Pushimet fillojnë më 24 dhjetor 2020 dhe mbarojnë më 4 janar 2021.
 - c) Provimet e Maturës Shtetërore zhvillohen në periudhën 2 - 30 qershor 2021.

3. Në arsimin profesional
 - a) Mësimet fillojnë më 14 shtator 2020.
 - b) Nxënësit e klasave të 10-ta për të gjitha strukturat, nxënësit e klasave të 12-ta për strukturën, 2+2 si dhe nxënësit e klasave të 11-ta dhe të 12-ta për strukturën 4-vjeçare përfundojnë mësimet më 15 qershor 2021.
 - c) Nxënësit e klasave të 11-ta dhe të 12-ta për strukturën 2+1+1 dhe nxënësit e klasave të 11-ta për strukturën 2+2 përfundojnë mësimet më 1 qershor 2021.
 - c) Për të gjithë nxënësit maturantë, viti shkollor përfundon më 25 maj 2021.
 - d) Pushimet fillojnë më 24 dhjetor 2020 dhe mbarojnë më 4 janar 2021.
 - dh) Provimet përfundimtare të Nivelit I dhe II zhvillohen në periudhën 1 - 15 qershor 2021.

- e) Provimi përfundimtar i praktikës profesionale të Nivelit III zhvillohet në periudhën 26 maj - 1 qershor 2021.
- f) Provimet e Maturës Shtetërore zhvillohen në periudhën 2 - 30 qershor 2021.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhri, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, dhe të gjitha institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar.

Ky Urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT

SPORTIT DHE RINISË

Besa SHAHINI



MINISTRI I FINANCEVE

DHE EKONOMISE

Anila DENAJ

